

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikostruksion i rrjetit TU me kabell ABC dhe i kabinave ne rrethinat e Librazhdit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231400-9, Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 119.982.087,89 (njqind e nentembedhjete milion e nenteqind e tetedhjete e dy mije e tetedhjete e shtate presje tetedhjete e nente) lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga te ardhurat e OSSH sh.a

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e perllogaritur e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa "b" VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e perllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin

ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: **i)** totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; **ii)** shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; **iii)** ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga organet e pushtetit lokal (Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. *(neni 88, pikë 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.
 2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.
- Konkretisht, për kontrata të realizuara me **ent publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
 - b) *Kontrate Sipërmarrje*
 - c) *Situacionin përfundimtar*
 - d) *Akt kolaudimi objekti*
 - e) *Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*
- Konkretisht, për kontrata të realizuara me **sektorin privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- a) *Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojës në DST për realizimin e punimeve*
 - b) *Kontrate Sipërmarrje*
 - c) *Situacionin përfundimtar*
 - d) *Akt kolaudimi objekti*
 - e) *Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruar në organet tatimore*

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit;

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara autoritetet kompetente shtetërore;

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga autoritetet kompetente , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- N.P. 1- A Punime germimi në toke;
- NP- 11- D Ndërtime për n/stacionet,kabinat e transformatoreve.linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

- N.S –18 - A Punime topogjeodezike. .

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet të paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsiper punimet për të cilat kërkohet Licenca Profesionale.

*Kur Operatori Ekonomik është i huaj ai duhet të paraqesë licencën e ekuivalentuar me kategoritë e kërkuara.

6. Objekti i kontrës është: "Fideri i Tomorricës TM/TU rikonstruktion"

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

8. ~~Fondi i punës 103,000,000 leke plotësojnë kërkesat e kësaj VSH~~
 9. ~~Justifikimi, argumentat përkatës dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit: Bazuar në nenin 75 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", dhe në nuk korespondojnë me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një Rekomandimin e APP ardhur me e-mail të datës 02.10.2023.~~
 10. ~~Operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjines~~

Argumentimi:

10. Nëse shtyhet afati i fundit për pranimin e ofertave, të shënohet afati i ri i përcaktuar: Jo, nuk shtyhet afati.

Licencat profesionale përputhen me natyrën, përmasat dhe vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. ~~Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas jllit nr. 62 datë 23.12.2020 për projektin preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162 të datës 23.12.2020 "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar), nën 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.03.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe VKM nr. 142, datë 16.01.2008 për nevojshatëzgjatjeRegulor kolportatitues shofertave~~

ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt si me poshte:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P1	Punime germimi ne toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	Punime F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell furnizimi + aksesori	D	101-200 milion leke
N.S -18	Punime topogjeodezike	Piketim shtyllash	A	0-20 milion leke

2.3.3 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent

- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- ISO 45001 : 2018 (Shendeteti dhe siguria ne pune) ose ekuivalent

objektet e te cilave te perputhen me objektin e prokurimit

*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues,te njohur nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ne Shqiperi(DAP).

*Operatori ekonomik mund te paraqese certifikatat e mesiperme sipas standarteve shqiptare mbi komformitetin e standartit europian dhe te leshuara nga organizma te vlersimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat e mesiperme ISO, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje".

Argumentimi :

Lidhur me kriterin e kerkuar si me siper,komisioni eshte bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020"Per prokurimin publik"neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021"Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik",ku nisor nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: *"Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit."*

Komisioni vendosi të kërkoje certifikatat e mësipërme për te vërtetuar qe Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimit e cilesise se punimeve,i lidhur ngushte me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B "Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo te rrezikshme" shoqeruar me Akt-Miratimin nga Agjencia Kombetare e Mjedisit sipas zerave perkates te punimeve ne preventiv ose te kete kontrate sherbimi noteriale per objektin konkret me shoqeri te licensuara.

Argumentimi: Kriteri per licencen e leshuar nga QKL me kodin III. 2. B eshte vendosur qe AK te kete sigurine qe operatori ekonomik qe do te ofertoje te jete i pajisur me certifikatat e mesiperme ose te kete kontrate sherbimi me subjekte te licencuara me licencen e lartepemendur, te lidhura me objektin e prokurimit, gje e cila krijon bindjen dhe sigurine te Autoriteti Kontraktor qe ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike per realizimin me sukses te kontrates.

Në seksionin "Kategoria III.2. "Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis", nënseksioni "Licencimi i kategorisë III.2.B", pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta",

të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngrurta, gjatë kryerjes së veprimtarisë ose të këtyre kontratave shërbimi materiale për objektin konkret me shoqëri të licensuara si më sipër.

Sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se referuar Preventivit të Punimeve, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar kryerjen e punimeve të cilat gjenerojnë mbetje. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbetjeve i cili referuar kuadrit ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licensuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.

2.3.5 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. Librezë pune (përkatëse)
- ii. CV përkatëse
- iii. Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi :

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme

teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

VKM Nr.42 date:16.1.2008”Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi”-kreu IV,pika 1/a dhe ligjit nr.8402 date 10.9.1998”Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”,neni 8 ku citohet:

Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore." Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane.

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si me poshte:

- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder/ Gjeomatik

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas nje standarti te pershtatshem cilesie.Per sa me siper,eshte e nevojshme qe Operatoret ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratatata te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndertimit: është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me betonimet e shtresat e betoni, çakull, etj.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketime në lidhje me pozicionimin linjave nentokesore në terren.
- Inxhinieri Elektrik: është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

2.3.7 Fuqia punëtore e operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit të jetë minimalisht **60 punonjës**. Afati i punimeve duke gjykuar mbi natyrën dhe volumin e punimeve që do të kryhen do të jetë 180 ditë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetedeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjesve të ketkuar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual).
- b) Liste pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të vitit ushtrimor (aktual).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik të Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8 të DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të pakten **15 punonjës** të specializuar/kualifikuar, të cilët duhet të jenë me statusin **elektriciste**, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë, të pajisur me kontratë pune, dëshmi profesionale (diplome, certifikata trajnime etj) si dhe dëshmi kualifikimi të Sigurimit Teknik.

Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo më pak se 60 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – jo më pak se 2 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – jo më pak se 10 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi – jo më pak se 15 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila – jo më pak se 2 copë

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatorët Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Numri i fuqisë punetore u llogarit duke u bazuar në volumnin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit dhe afatit 180 ditë për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin ze, u llogarit shifra prej 60 punonjës.
- Komisioni vlerëson se të paktën 15 punonjës duhet të jenë pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshuara nga Inspektorati Qendror Teknik ose nga organi kompetent në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, datë 14.02.2013, të cilët të jenë elektrikist dhe me deshmime perkatese të formimit.
Keto deshmi duhet të kerkohen për shkak të natyrës së punimeve ,punonjesit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë për caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë : 1(nje) Inxhinier Elektrik ,1 (nje) Inxhinier Ndertimi,1 (nje) Inxhinier Gjeodet,1 topograf që të mbikëqyrin punimet në fazën e zbatimit. Keta inxhinier kanë lidhje edhe me licencat profesionale që duhen për zbatimin e projektit.
- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.
- Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.9 Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar në stafin 1 (një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e individuale të punës,
- diplomën universitare.
- licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit.

Nëse OE nuk kanë në stafin e tyre persona përgjegjës me aftësi dhe kualifikimet e duhura lidhur me ceshtjet e shendetit në pune (nëse nuk kanë mjek të punësuar) mund ti sigurojnë këto shërbime me anë marrëdhënieve kontraktore (të paraqitet kontrata e vlefshme, diploma universitare dhe licenca përkatëse për ushtrimin e profesionit) me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Eshtë bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punësimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

2.3.10 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **4 (kater)** punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilet **2 (dy)** automakinist dhe **2 (dy)** eskavatorist.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë në rast se mjete e punes (makinerite) janë në pronësi të operatorit.

Në rastet kur makinerite **disponohen me qira**, nuk është e nevojshme që manovratorët e mjeteve të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Në këtë rast ata duhet të kenë të vlefshme vetëm kontratën e punës dhe dëshmitë e drejtimit.

Kamion vetëshkarkues ,kapaciteti mbajtës minimum 5 (pese) ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet deri në 3.5(tre pike pese) ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc / Kamion me vinc, kapaciteti mbajtes minimum 3.5(tre pike pese) ton.	1 copë	Pronësi ose me qera
Betoniëre 500l	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator	2 copë	Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Moto Gjenerator	2 copë	Pronësi ose me qera
Makine kosh	2 copë	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Minidamper	1 copë	Pronësi ose me qera
Instrument per piketim (GPS)	1 copë	Pronësi ose me qera
Terameter	1 copë	Pronësi ose me qera
Megaohmeter	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Për mjetet e përmendura më sipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

1-Analizat e çmimeve të zerave të preventivit janë marrë në bazë VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare Nr.66 datë:19.04.2023.

2 – Analizat teknike që nuk janë në VKM Nr.216 datë 13.04.2023, janë hartuar si zera jashtë liste bazuar në librin Nr.6 "Montimi i linjave dhe nestacioneve elektrike" si edhe në librin e "Normave komunale".

3 - Çmimet e bazës materiale janë marrë në bazë të manualit të SAP-it-OSSH, studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vete autoriteti Vendim nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

4 - Volumet e gërmimeve, betonimeve dhe të montimeve janë marrë sipas standarteve të OSSH Sh.a bashkëngjitur projektit.

5 - Paga orare është marrë 367.12 leke sipas VKM Nr.216 datë 13.04.2023.

6 - Për punimet e montimit që nuk janë në manual i referohemi Udhëzimit nr.2 datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

7 - Shpenzimet plotësuese janë marrë 8 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023

8 - Norma e fitimit është marrë 10 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.11 Për Listën e mëposhteme të artikujve:

- Kabell ABC me vetëmbajtje izol. XLPE AL 0.6-1 kV 4x (25-95mm²)
- Kabell koaksial TU CU (1x6/6)mm²
- Shtylla betonarme të centrifuguara 9/6 m/kN, 9/15 m/kN
- Terminale TU 0.6-1 kV
- Tirantues linje 4x(16÷70)mm²

Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- *Operatori ekonomik në rastin kur nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, fax, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor*

në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike ose ekuivalenti i tij/saj) nga të cilat specifikimet teknike të produkteve të kërkuara të jenë në gjuhën e ofertes. Në rastet kur marrëveshjet janë në gjuhë të huaj, duhet të bëhet përkthimi në gjuhën shqipe dhe noterizimi i tij.

- *Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve (skedat teknike) të prodhuesit për listën e artikujve si më sipër, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.*
- *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara (Test raportet për listën e mësipërme të artikujve, nëse rezultojnë në gjuhë të huaj, duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen - kjo sipas VKM Nr. 285 datë: 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik")*

Argumentimi: 1. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipërcituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

2. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e bleresit. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

3. Kjo kerkese ne lidhje me testimet zyrtare eshte ne perputhje me piken 6/c, te nenit 40 te VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Së pari, paraqitja e deshmive të testeve zyrtare siguron një burim të besueshëm të informacionit për cilësinë e mallrave. Testimet zyrtare janë kryer nga institucione të pavarura dhe të autorizuar ose nga prodhuesi i vetë mallrave, duke garantuar pavarësinë dhe besueshmërinë e rezultateve. Ky informacion është i rëndësishëm për AK për të siguruar që mallrat janë të pajtueshme me specifikimet dhe standartet e kërkuara.

Së dyti, kriteri për deshmitë e testeve zyrtare ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve. Duke përdorur informacionin e testeve zyrtare, AK mund të identifikojë përparësitë dhe mangësitë e çdo oferte potenciale. Duke kërkuar paraqitjen e deshmive të testeve zyrtare, AK mund të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomikë kanë një mundësi të barabartë për të demonstruar cilësinë dhe pajtueshmërinë e mallrave të tyre. Kjo nxit konkurrencën e drejtë dhe siguron që oferta më cilësore të fitojë kontratën.

2.3.12 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të ketë te punësuar ne stafin e shoqerise se tij:

- 1 Specialist qe te disponoje Certifikate si ”Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”.

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

Argumentimi: Ne baze te VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe Shendetin ne Pune” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 per :Miratimin e rregullores”Per sigurine ne Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarre, do të shmangëedhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do ti realizoje ato sipas standarteve ligjore ne fuqi.

➤ Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike , jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat qe do te vendosen ne linjat elektrike qe po prokurohen, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar. Keto specifikime jane te unifikuara per te gjitha institucionet e varesise te OSSH-sha.

Sqarim: Cdo kriter i parashikuar ne nenin 26, pikë 2 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) dhe ne shtojcen nr. 8 te Dokumentave Standarte te Tenderit, përmbushet nga Operoret Ekonomik nepermjet paraqitjes se Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Ne baze te nenit 26 ,pika 6, i VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ” (i ndryshuar) , “ “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.”.

Ne rast bashkimi te opratoreve ekonomik, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. (neni 88, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ”)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT